



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA JURIDIKE, BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 4505/5 prot.

Gramsh, më 05/11/2024

Lënda: Njoftim për shpalljen e listës paraprake të kandidatëve që do të nënshtrohen fazës së dytë të konkurimit, për vendet e shpallura të lira me Njoftimin nr.4505, datë 15.10.2024.

AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Adresa: Bulevardi "B. Curri" pranë ish-Hotel "Arbana"

TIRANË

Pas përfundimit të afatit të dorëzimit të dokumentacionit dhe verifikimit paraprak të aplikimeve të dorëzuara pranë zyrës së protokoll-arkivit, për procedurën e lëvizjes paralele dhe pranimin nga jashtë në shërbimin civil, për vendet e shpallura të lira me Njoftimin nr.4505/4, datë 04.11.2024, Njësia Përgjegjëse, Ju dërgon listën e kandidatëve që do të nënshtrohen fazës së dytë të konkurimit.

Njoftimi i shoqëruar me shkresë për sa më sipër, do t'ju niset edhe me E-mail, në adresën: vendetelirapune@akpa.gov.al

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI

BESION AJAZI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA JURIDIKE, BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 4505/4 prot.

Gramsh, më 04/11/2024

**NJOFTIM MBI REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK
PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE (specialist jurist)**

Lloji i diplomës “Shoqërore” niveli minimal i diplomës “Bachelor”

Në zbatim të nenit 25 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II, të Vendimit Nr. 243 datë 18/03/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” të Këshillit të Ministrave (ndryshuar me VKM nr.764, datë 19.012.2018),

Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Gramsh në përfundim të verifikimit paraprak të kandidatëve, për përmbushjen e kushteve të pranimit nga jashtë në shërbimin civil dhe kërkesave të veçanta të shpallura në shpalljen për konkurrim, njofton se kandidatët e kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të testimit, janë:

1. Ksivja Zani

Testimi me shkrim dhe intervista me gojë (pas testimit me shkrim) do të zhvillohen, në ambientet e Bashkisë Gramsh, sallën e mbledhjeve në datën 21.11.2024 ora 11.00. Kandidatët të cilët kanë grumbulluar në vlerësimin me shkrim më shumë se gjysmën e pikëve do të kalojnë në intervistën e strukturuar me gojë.

KRYETARI

BESION AJAZI

